



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i komunës së Rahovecit – Skupština opštine Orahovac

Në bazë të nenit 6, të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr. 04/L-144, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/ 17 dhjetor 2012), nenit 12, të Rregullores së QRK nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 14, paragrafi 1, të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe nenit 5. të Statutit të komunës së Rahovecit, Kuvendi i komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 9 dhjetor 2015, nxjerr këtë

V E N D I M

I.- APROVOHET propozimi i Kryetarit të komunës 01 nr. 122/2015 të dt. 21. 10. 2015, për shpalljen e interesit publik, për zhvillimin ekonomik të veprimtarisë së biznesit dhe dhënies në shfrytëzim afatgjatë me periudhe kohore deri 40 (dyzetë) vite, personave fizik dhe juridik, duke zhvilluar procedurën e rregullt të konkurrimit të hapur nëpërmjet ankandit publik, dhe ato për ngastrën kadastrale nr. 265-0, sipas kulturës mal i kl. 5, në sipërfaqe prej 855 m2, ngastrën nr. 331-0, sipas kulturës kullosë e kl. 6, në sipërfaqe prej 1037 m2 dhe ngastrën nr. 1022-0, sipas kulturës kullosë e kl. 6, në sipërfaqe prej 9574 m2 z.k. Hoçë e Madhe, dhe për ngastrat nr. 4997, sipas kulturës kullosë e kl. 4, në sipërfaqe prej 1424 m2 dhe 5483-0, sipas kulturës kullosë e kl. 3, në sipërfaqe prej 4808 z.k. Rahovec

II.- Ngastrat të cekura më lartë nëpërmjet personit zyrtar dhe ekspertit të gjeodezisë të Drejtorisë për kadastër, gjeodezi dhe pronë, në vendin e ngjarjes është konstatuar se janë të lira dhe nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllime.

III.- Për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik, do të zhvillohet procedura e rregullt e konkurimit të hapur, siç është përcaktuar me nenin 6. Paragrafi 2, të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr. 04/L-144 dhe nenit 12, të Rregullores së QRK për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr. 23/2013.

IV.- Të drejtat dhe përgjegjësitë e komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim afatgjatë për kohëzgjatje prej 40 (dyzetë) vite do të rregullohet me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i komunës dhe përfituesit të marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.


V.-Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i komunës, organi kompetent për pronë dhe organi kompetent për regjistrimin e pronës së paluajtshme.

VI.- Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit të tij në ueb faqen e komunës.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

01 nr. 223/2015

Rahovec, më 09.12. 2015




Kryesuesi i Kuvendit
Nahit Elshani


2. K. RAHOVEC
Nr. parc 548310 $\rightarrow S = 4808 \text{ m}^2$
Nr. parc 499710 $\rightarrow S = 1424 \text{ m}^2$



Z. F. H. MADHUS
Nº. parc. 1022
S = 9574 m²



Z. K. H. MADHE
N. i. parc 33110
S = 1037 m²



2K. H. MOORE
Nr. par. 265/0
S = 855 m²

